



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I MJEKËSISË, TIRANË
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1045/2 prot.,

Tiranë, më 28.03.2023

VENDIM

Nr. 23, datë 28.03.2023

PËR

**“MIRATIMIN E LISTËS SË STUDENTËVE TË CILËT PËRFITOJNË ULJE TË
TARIFËS SË SHKOLLIMIT, PËR VITIN AKADEMIK 2022-2023 DHE STUDIOJNË NË
NJË PROGRAM STUDIMI TË CIKLIT TË DYTË, NË UNIVERSITETIN E
MJEKËSISË, TIRANË”**

Në bazë të Ligjit Nr. 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.780, datë 26.12.2018 “Për përcaktimin e kategorive të individëve që plotësojnë kriteret për ulje të tarifës vjetore të studimit në programet e ciklit të dytë të studimeve, në institucionet publike të arsimit të lartë”, pika 1 e tij, Bordi i Administrimit, pasi mori në shqyrtim relacionin e Administratorit të UMT-së nr. 988/1 prot., datë 23.03.2023 “Mbi miratimin e listave të studentëve të ciklit të dytë që përfitojnë ulje të tarifës vjetore të studimit, për vitin akademik 2022-2023, sipas kriterit ekonomik”, në mbledhjen e datës 28.03.2023,

VENDOSI:

1. Të miratojë listën e 60 (gjashtëdhjetë) studentëve, të cilët përfitojnë ulje të tarifës së shkollimit, për vitin akademik 2022-2023 dhe studiojnë në një program studimi të ciklit të dytë, në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Efekti financiar total është 2,886,000 (dy milion e tetëqind e tetëdhjetë e gjashtë mijë) lekë dhe përballohet nga buxheti i shtetit si pjesë e grantit të mesimdhënies së vitit 2023.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Administratori i Universitetit të Mjekësisë, Tiranë.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqjen zyrtare të UMT-së.

**KRYETAR
ZAMIRA GJINI**

ANËTARË

VERA OSTRENI

MONIKA FIDA

ALBANA GJINOPULLI

ANIS THODHORJANI

ALTINA XHAFERI

ENDRIT YZEIRAJ